

VENDIM
Nr. 906, datë 18.11.2020

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, TË PRONËS SHETETËRORE, ME
NUMRA PASURIE 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, PJESË E ZONËS KADASTRALE
NR. 8517, BASHKIA DURRËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE DURRËS, NË ZONËN
E ISH-KËNETËS, SPITALLË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore, me numër pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, pjesë e zonës kadastrale 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën e ish-Kënetës, Spitallë, me vendndodhje dhe sipërfaqe sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, do të përdoren nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zhvillimin e një parku fotovoltai.

3. Sipërfaqes së zonës teknologjike dhe zhvillimit ekonomik, të shpallur me vendimin nr. 262, datë 6.4.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës", i hiqen pronat shtetërore të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI I

Zona kadastrale 8517, Bashkia Durrës, njësia administrative Durrës

ZONIMI	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. ha
ZONA FOTOVOLTAIKE	8517	46	arë	14,25
	8517	63	arë	11,72
	8517	64	arë	12,72
	8517	65	arë	12,27
	8517	66	arë	12,35
	8517	47	arë	14,10
	8517	48	arë	14,00
	8517	49	arë	14,60
	8517	50	arë	13,50

119,51
KANALE: 1,34
TOTALI: 120,85